

Sondazhi i opinionit publik

2015
BESIMI NË QEVERI



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Policy Association for an Open Society

Sondazhi i opinionit publik

Besimi në qeveri

2015

Tiranë, dhjetor 2015



*Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian*



Empowered lives. Resilient nations.

© 2016 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Autorë:

Erisa Lame

Aleka Papa

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, 1. PO BOX 8177 Tirana, Albania

E-mail: info@idmalbania.org

Adresa në internet: www.idmalbania.org

Përmbajtja e këtij raporti nuk pasqyrojn opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe të UNDP-së. Përgjegjësia për informacion dhe pikëpamjet e shprehura në raport qëndrojnë tërësisht me autorët.

PËRMBLEDHJE

EKZEKUTIVE

Ky sondazh i opinionit synon të evidentojë nivelin e besimit të publikut tek institucionet qeveritare si dhe qëndrimin e qytetarëve ndaj punës së institucioneve publike dhe ofrimit të shërbimeve në Shqipëri. U përdor përçasja e kampionit me kuotë, duke zgjedhur një numër të barabartë të intervistuarish nga secila prej 61 bashkive në vend, me një kampion prej 1,600 të intervistuarish.

BESIMI: Në Shqipëri nivelin më të lartë të besimit e gëzon NATO (74%) dhe BE (72%). Institucionet fetare zënë vendin e tretë me besimin më të madh. Mbi 1 në 2 shqiptarë të anketuar (52%) deklarojnë se u besojnë institucioneve fetare. 1 nga 3 qytetarët e anketuar (34%) i besojnë qeverisë. Qeveria (34%) gëzon besim më të madh se Parlamenti (22%). Shqiptarët kanë aq besim tek media (39%) sa ç'kanë edhe tek organizatat jo-fitimprurëse (38%). Sistemi gjyqësor (80%) dhe partitë politike (79%) janë institucionet më pak të besuara. Institucionet që kanë pësuar rënien më të madhe të besimit në vitin 2015 janë: Parlamenti (nga 29% në 22%) dhe sistemi shëndetësor (nga 32% në 27%). Media është i vetmi institucion që nuk ka pësuar ndryshim në nivelin e besimit. Nga ana tjetër, institucionet fetare kanë treguar rritjen më të lartë në nivelin e besimit (nga 44% në 52%). Që nga viti 2013, gjyqësori dhe institucionet e sistemit arsimor po përballen me një rënie të besimit publik në krahasim me policinë, e cila po përjeton një rritje të qëndrueshme.

TRANSPARENCA E QEVERISË DHE TË DHËNAT E HAPURA: Opinioni publik është i ndarë në qëndrimin e tij nëse institucionet publike shqiptare janë transparente dhe të përgjegjshme në punën e tyre të përditshme. 47% e qytetarëve të anketuar besojnë se institucionet publike shqiptare nuk janë transparente dhe të përgjegjshme, në krahasim me 41% që besojnë të kundërtën. Pranohet gjerësisht nga qytetarët rëndësia dhe përfitimet e të dhënave të hapura. Pak më shumë se 9 në 10 shqiptarë të pyetur besojnë se politikat e të dhënave të hapura rrisin besimin e qytetarëve tek qeverisja, forcojnë marrëdhëniet mes qeverisë dhe qytetarëve të saj, përmirësojnë jetën e njerëzve, dhe, si përfundim, nxisin zhvillimin ekonomik.

KORRUPSIONI TEK INSTITUCIONET PUBLIKE: Për sa i përket qeverisë qendrore, edhe pse afro 1 në 3 shqiptarë të anketuar (34%) raportojnë të kenë qenë dëshmitarë të një rasti korrupsioni, një përqindje e madhe e qytetarëve (53%) pohojnë se nuk kanë qenë të ekspozuar ndaj korrupsionit. Numri i rasteve personale të korrupsionit është më i lartë në qeverisjen vendore. Pjesa më e madhe e të anketuar ose 41% raportojnë se kanë qenë dëshmitarë të një rasti korrupsioni në bashkinë ku jetojnë, ndërsa 34% nuk raportojnë ndonjë përvojë të tillë. Në të dy nivelet e qeverisjes, qendrore dhe vendore, përvetësimi (abuzimi me/ose vjedhje të fondeve publike) duket se është forma më e zakonshme e korrupsionit që ndodh. Patronazhi dhe shantazhi janë dy format më pak të pranishme të korrupsionit, siç perceptohet nga qytetarët.

ANGAZHIMI QYTETAR ME QEVERINË: Edhe pse besojnë se kanë njohuri të mjaftueshme për të gjykuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq për shoqërinë shqiptare (62%), qytetarët nuk duket se besojnë në efikasitetin e mekanizmave që mundësojnë angazhimin e tyre në hartimin e politikave dhe në vendimmarrje, duke ia dhënë kështu Parlamentit autoritetin për hartimin e politikave publike dhe kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Si rezultat, 80% e të anketuarve besojnë se deputetët duhet të marrin përsipër përgjegjësinë e qytetarëve për të formësuar politikat publike. Gjetjet evidentojnë një nivel shqetësues të apatisë që karakterizon shoqërinë shqiptare; çështje të një rëndësie të jashtëzakonshme, që duhet të merren në shqyrtim të mëtejshëm nga institucionet përkatëse (qeveria, organizatat e shoqërisë civile, donatorët, etj.).

LLOGARIDHËNIA E QEVERISË: Për sa i përket mekanizmave të llogaridhënies, 79% e qytetarëve të anketuar besojnë se Parlamenti është institucioni me ndikimin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Perceptimi i publikut duket se është i ndarë për rolin që ka Avokatit i Popullit për t'i kërkuar llogari qeverisë. Ndërkohë, vetëm 35% e qytetarëve të anketuar besojnë se organizatat e shoqërisë civile shqiptare mund ta bëjnë qeverinë të japë llogari.

TIK DHE QEVERISJA E MIRË: Pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar (65%) besojnë se teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mund të përmirësojë qeverisjen, ndërsa 1 në 5 qytetarë (25%) nuk është në dijeni ose nuk ka informacionin e nevojshëm mbi mundësitë që mund të ofrojë TIK për të forcuar qeverisjen e mirë. Në anën tjetër, qytetarët nuk përdorin TIK-un si një nga mjetet për t'u lidhur me njësinë e tyre të qeverisjes vendore (bashkinë).

PERFORMANCA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE: Tre institucionet të renditura më lart për performancën e tyre janë institucionet fetare, policia dhe forcat e armatosura, të cilat vlerësohen pozitivisht përkatësisht nga 29%, 23%, dhe 22% e shqiptarëve të anketuar. Institucionet që vlerësohen më ulët nga opinioni publik janë gjyqësori dhe partitë politike. Edhe pse ekziston një perceptim i përhapur që institucionet publike nuk po punojnë edhe aq mirë në kryerje e funksioneve të tyre kryesore, pothuajse ¾ e qytetarëve të anketuar (ose 71%) besojnë se institucionet publike i kanë mundësitë për përmirësimin e performancës së tyre.

NDIKIMI POLITIK NË PUNËN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE: Gjyqësori (59% e qytetarëve të anketuar) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (55% e qytetarëve të anketuar) janë dy institucione që perceptohen se mbi të ushtrohet ndikim i lartë politik. Institucionet fetare (62%) perceptohen të jenë më të pavarura. Gati gjysma e të anketuarve besojnë se interesat politike kanë ndikim të madh në institucionet e sistemit shëndetësor (46%) dhe tek ato të sistemit arsimor (45%).

KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE: Përqindja e qytetarëve të anketuar që janë të pakënaqur me cilësinë e shërbimeve publike të ofruara është më e lartë se përqindja e atyre të kënaqur. Qytetarët e anketuar janë kryesisht të kënaqur me shërbimet e urgjencës (zjarrfikësi, policia, etj.) dhe shërbimet komunale (të ofruara në nivel vendor), me 38% dhe 34% të anketuar, përkatësisht. Nga ana tjetër, më shumë se gjysma e qytetarëve nuk janë të kënaqur me shërbimin e punësimit (59%), me shërbimin gjyqësor (56%) dhe me atë shëndetësor (53%).

Pasqyra e lëndës

HYRJE **6**

METODOLOGJIA **7**

DEMOGRAFIA E KAMPIONIT **8**

GJETJET **11**

Besimi tek institucionet publike **11**

Perceptimet për Transparencën e Qeverisë dhe të Dhënat e Hapura **17**

Perceptimi i korrupsionit në institucionet publike **21**

Perceptimet për angazhimin e qytetarëve me qeverinë **24**

Perceptimet për llogaridhënien e qeverisë **28**

Perceptimet për TIK dhe qeverisjen e mirë **32**

Perceptimi për performancën institucioneve publike **36**

Ndikimi politik në punën e institucioneve publike **39**

Perceptime për konsideratat gjinore në lidhje me politikat publike **42**

Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike **45**

POSHTËSHËNIME **50**

PYETËSORI **53**

HYRJE

Sondazhi i Opinionit Publik “Besimi në Qeveri” (që në këtë botim do të quhet “Sondazhi i Opinionit”) është instrument për të mbrojtur dhe monitoruar standardet për qeverisjen e hapur, qeverisjen e mirë dhe shtetin ligjor në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.¹ E ndërtuar mbi një metodologji të përbashkët, nga viti 2013 Sondazhi i Opinionit kryhet çdo vit në nivel kombëtar në secilin nga këto gjashtë vende. Në Shqipëri, ai është kryer në nëntor të çdo viti dhe është mbështetur financiarisht nga PNUD në Shqipëri.

Sondazhi i Opinioni kryhet në kuadër të Projektit “Advokim për Qeverisjen e Hapur”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga gjashtë organizata të njohura jo-qeveritare² në secilën nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, brenda periudhës 2012-2016. Objektivi i projektit është të nxisë qeverisjen dhe politikëbërjen gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme dhe transparente nëpërmjet përmirësimit të ekspertizës së shoqërisë civile dhe forcimit të strukturave për dialog mes shoqërisë civile dhe qeverisë në kuadër të Nismës së Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (PQH).

Nën suazën e PQH-së, projekti trajton objektivin e përgjithshëm të procesit të integritetit të rajonit në BE si dhe përqafimin e vlerave dhe strukturave demokratike duke siguruar aftësitë për shoqërinë civile dhe lidhje më të ngushtë mes shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare. Për këtë qëllim, aktivitetet janë hartuar për gjatë tre fushave kryesore: 1) Analizë dhe Monitorim Politikash; 2) Advokim për hartuesit e politikave dhe krijimin e koalicionit të OShC; dhe 3) Edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit.

Në Shqipëri, projekti po zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përkatëse publike në nivel qendror dhe vendor, me organizatat e shoqërisë civile dhe me përkrahjen e organizatave donatore që nxisin zbatimin e parimeve PQH në vend.

METODOLOGJIA

Ky sondazh i opinionit publik synon të evidentojë nivelin e besimit të publikut tek institucionet qeveritare si dhe qëndrimin e qytetarëve ndaj performancës së institucioneve publike dhe ofrimit të shërbimeve në Shqipëri. Si e tillë, ai ka nevojë për një përjasje metodologjike sasiore. Për këtë qëllim, u hartua, pilotua dhe më pas u administrua një pyetësor me një kampion prej 1,600 të anketuar duke synuar mbulim gjeografik në të gjithë vendin. U përdor përjasja e kampionimit me kuotë për të zgjedhur një numër të barabartë të intervistuarish nga të 61 bashkitë e vendit. Kjo teknikë kampionimi, edhe pse me kampion pa probabilitet që nuk mundëson përgjithësimin e të gjithë popullsisë, është më i përshtatshmi kur synohet t'i jepet “zë” opinionit të të gjithë qytetarëve pavarësisht afërsisë me qeverinë qendrore, me shërbimet e centralizuara, etj. Po ashtu, në përzgjedhjen e kuotave të barabarta për secilën zonë, u përfshinë një larmi e madhe profilesh të të anketuarve për sa i përket gjinisë, moshës, nivelit arsimor, gjendjes së punësimit, si dhe të ardhurave, edhe pse disa nga këto karakteristika nuk mund të paracaktohen duke qenë se përzgjedhja e të anketuarve ishte e rastësishme e kushtëzuar nga madhësia e kampionimit me kuotë të rajoneve administrative në Shqipëri.

Instrumenti: U hartua një pyetësor duke përfshirë pyetje të mbyllura të organizuara në seksionet e mëposhtme:

- **Në Seksionin 1:** u mblodhën të dhëna për demografinë, d.m.th., gjinia, moshë, nivel arsimor, punësimi dhe të ardhurat individuale.
- **Në Seksionin 2:** u mblodhën të dhëna për nivelin e perceptuar të besimit, transparencës, llogaridhënies, pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes dhe përdorimin e teknologjisë si mjet komunikimi i qytetarëve me qeverinë e tyre vendore.
- **Në Seksionin 3:** u mblodhën të dhëna për nivelin e perceptuar të kënaqshmërisë për cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike dhe konsiderata gjinore në politikën dhe shërbimet publike.

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave

The survey questionnaire was administered in face-to-face interviews using PAPI (paper assisted personal interview). All data was entered in a common database, processed and analyzed to present findings of descriptive and relational statistics, with the aim of providing general trends, complemented with more detailed analysis based on demographic characteristics (age, education background, employment status etc).

DEMOGRAFIA E KAMPIONIT

U anketuan në të gjithë vendin gjithsej 1,600 qytetarë shqiptarë të moshës 18-65 vjeç dhe mbi këtë moshë (shih seksionin e metodologjisë). Të dhënat kryesore demografike të kampionit përfundimtar të të anketuarve në lidhje me gjininë, moshën, arsimin, statusin e punësimit dhe të ardhurat individuale jepen më poshtë.

Kampioni i popullsisë kishte 50% femra dhe 50% meshkuj. Kampioni është më i ri dhe më i arsimuar sesa popullsia mesatare. Pjesa më e madhe e të intervistuarve janë të grup moshës 18-35 (48%). Për sa i përket nivelit të arsimimit, 4 në 10 qytetarë të anketuar kanë përfunduar shkollën e mesme dhe rreth 43% tashmë kanë ose janë në proces të marrjes së një diplome universitare ose pasuniversitare. Afërsisht 12% kanë kryer vetëm arsimin e detyrueshëm.

Fig. 1

Përfaqësimi sipas gjinisë





Tabela 1. Niveli arsimor

I/E pa-arsimuar	2%
Mbaruar shkollën fillore – 4 vjeçare	2%
Mbaruar shkollën 8/9 - vjeçare	12%
Mbaruar shkollën e mesme	40%
Diplomë universitare / më lart	43%
REFUZIM	1%

Fig. 2

Përfaqësimi sipas moshës




Sa i përket gjendjes së punësimit, rreth 45% e kampionit janë të punësuar, ndërsa 28% janë të papunë. 9% e të anketuarve janë studentë dhe 11% janë pensionistë.

Tabela 2. Gjendja e punësimit

I/E punësuar	45%
I/E pa punësuar – kërkon punë	22%
I/E pa punësuar – nuk kërkon punë	6%
Student	9%
Pensionist	11%
Tjetër	7%

Fig. 3

Të ardhurat e rregullta individuale mujore



Shpërndarja e të ardhurave mujore individuale të qytetarëve paraqitet në Fig. 3.

Afërsisht, 81% e të anketuarve jetojnë në qytete dhe 19% në zonat rurale.

Konsideratat etike

Procesi i mbledhjes së të dhënave u krye në anonim të plotë duke siguruar konfidencialitetin e të dhënave që u morën.

GJETJET

Besimi tek institucionet publike

David Easton e përkufizon besimin si të pasurit e një perceptimi pozitiv për veprimet e një individi apo organizate. Është dukuri subjektive, e reflektuar në “sytë e spektatorit” që ka rëndësi për atë sa formëson sjelljen. Besimi tek qeveria përfaqëson mirëbesimin e qytetarëve në veprimet e “qeverisë për të bërë atë që është e drejtë dhe që perceptohet si e paanshme”³ (Easton, 1965). Sipas OECD⁴, besimi në institucionet publike është i rëndësishëm për suksesin e shumë politikave publike, programeve dhe rregulloreve që varen nga bashkëpunimi me qytetarët dhe respektimi i tyre nga këta të fundit. Mungesa e besimit kompromenton vullnetin e qytetarëve dhe bizneseve për t’iu përgjigjur politikave publike duke penguar në këtë mënyrë zhvillimin e qëndrueshëm. OECD identifikon gjashtë fusha ku qeveritë mund të punojnë për të krijuar dhe konsoliduar besimin e qytetarëve: besueshmëria, llogaridhënia (përgjegjshmëria), sinqeriteti, rregullore më të mira, integriteti dhe hartimi i politikave gjithëpërfshirëse. Të gjitha këto fusha përbëjnë një pjesë integrale të këtij Sondazhi të Opinioneve, në përpjekje për të kuptuar perspektivat dhe mendimet e shoqërisë shqiptare rreth këtyre çështjeve të rëndësishme.

Megjithatë, besimi nuk kufizohet vetëm tek aspektet specifike të sektorit publik. Ai përfaqëson një kombinim përvojash të ndryshme, stereotipesh dhe ideologjish që janë shumë të ndjeshme ndaj rezultateve të politikës dhe ndaj rrethanave më të gjera shoqërore dhe politike në secilin vend. Edhe faktorët socialë dhe demografikë, si niveli i arsimimit dhe formimit, gjinia dhe mosha, ndikojnë në besimin social dhe politik. Prandaj, është ndërmarrë një analizë të marrëdhënieve ndërmjet faktorëve demografikë të përmendur më lart dhe i rezultateve të dhëna nga sondazhi i opinionit.


Pas të dhënave demografike, në Seksionin 2 Pyetësori fillon duke i kërkuar qytetarëve të vlerësojnë nivelin e tyre të besimit ndaj një numri institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor si dhe në drejtim të disa aktorëve të tjerë të rëndësishëm (media, shoqëria civile, etj.). Dy institucione joshqiptare, përkatësisht NATO dhe Bashkimi Evropian (BE) janë shtuar në listë, kryesisht për shkak të nivelit të lartë të përfshirjes së këtyre institucioneve në jetën politike, ekonomike dhe sociale të shoqërisë shqiptare.

Të dhënat e 2015 tregojnë se institucionet më të besuara në Shqipëri janë NATO dhe BE, të cilat gëzojnë përkatësisht 74% dhe 72% të besimit publik (% e qytetarëve të anketuar që shprehën “Kam shumë besim” ose “kam pak besim”).⁵

Mes niveleve të ulëta të besimit tek institucionet e tjera, institucionet fetare gëzojnë vendin e tretë me besimin më të lartë. Më shumë se një çdo dy shqiptarë (52%) thonë se ata besojnë tek institucionet fetare; 15% nuk kanë asnjë mendim.



Fig. 4
Besimi 2015



Afërsisht një në tre shqiptarë të anketuar beson tek Qeveria; Qeveria (34%) duket se gëzon besim më të madh se Parlamenti (22%).

Qytetarët shprehin po aq besim për mediat (39%) sa edhe për organizatat jofitimprurëse (38%).

Sistemi gjyqësor (80%) dhe partitë politike (79%) renditen si institucionet më pak të besuara në anketë (% e të anketuarve shprehur “Nuk kam aspak besim” ose “Nuk kam besim”).

Parlamenti është institucioni i tretë me më pak besim; 75% e shqiptarëve të anketuar nuk kanë besim tek Parlamenti.

Pjesa më e madhe ose nëntë nga katërbëdhjetë (9/14) institucionet kanë mbi 50% të të anketuarve që nuk kanë shprehur besim. Disa prej tyre janë: sistemi i kujdesit shëndetësor (73%), Presidenti (68%), Qeveria (64%) dhe sistemi arsimor (64%).

Në krahasim me vitin 2014, analiza tregon se shtatë nga katërbëdhjetë (7/14) institucione kanë përjetuar një rënie ose asnjë ndryshim në nivelin e tyre të besimit. Institucionet që kanë pësuar rënien më të madhe të besimit në vitin 2015 janë: Parlamenti (nga 29% në 22%) dhe sistemi shëndetësor (nga 32% në 27%). Media është i vetmi institucion që nuk ka pësuar ndryshim në nivelin e besimit.

Krahasimi kohor: Nga ana tjetër, institucionet fetare kanë parë rritjen më të lartë në nivelin e besimit (nga 44% në 52%). Institucionet e tjera që kanë përjetuar një rritje të besimit nga viti 2014 janë: Policia (nga 41% në 45%), Presidenti (nga 25% në 29%), organizatat e shoqërisë civile (nga 34% në 38%) dhe Bashkimi Evropian (nga 68% deri 72%). Shih Fig. 5.

Për të tretin vit radhazi (2013, 2014, 2015), Bashkimi Evropian dhe NATO mbeten institucionet më të besuara në Shqipëri. Institucionet më pak të besuara janë partitë politike dhe gjyqësori.

Analiza krahasuese tregon se që nga viti 2013, gjyqësori dhe institucionet e sistemit arsimor po përballen me një rënie të besimit publik në krahasim me policinë, e cila po përjeton një rritje të qëndrueshme.

Kur analizohen rezultatet për nivelin e besimit tek institucionet të ndara sipas gjinisë, moshës, dhe nivelit arsimor të të anketuarve, të dhënat tregojnë si më poshtë:


Gjinia dhe Besimi: Ka pak dallim në besimin institucional mes gjinisë në përgjithësi. Disa mospërputhje mund të dallohen sa i përket besimit tek NATO, ku meshkuj (40%) që shprehin besim të madh tek NATO janë më shumë sesa femrat (32%); dhe 7% e të anketuarve femra pohojnë se nuk kanë ndonjë mendim. Gjithashtu, femrat priren të shprehin më pak besim se meshkujt në institucionet shëndetësore. 45% e femrave thonë se ato nuk u besojnë institucioneve të kujdesit shëndetësor, krahasuar me 39% të meshkujve të marrë në studim.

Mosha dhe besimi: Individë të moshës 55 vjeç e sipër janë më shumë të predispozuar të kenë besim më të madh tek Qeveria sesa të anketuarit e rinj në moshë. 40% e individëve të moshës 55 vjeç e sipër shprehin besimin tek Qeveria⁶ krahasuar me 1 në 3 persona në moshë



Fig. 5


Ndryshimi në besim (p.p.) 2014-2015






18-35 vjeç (32%) dhe 30% në moshë 36-55 vjeç. Shumica e individëve të moshës 36-55 vjeç (37%) nuk kanë besim tek qeveria në krahasim me 28% të atyre të moshës 18-35 vjeç. Nga ana tjetër, 1 në 10 persona të moshës 55 vjeç e sipër shprehin besim të madh tek qeveria. Po ashtu, individët e moshës 55 vjeç e sipër kanë më shumë gjasa të kenë besim më të madh tek policia në krahasim me popullsinë në moshë të re. Në mënyrë të veçantë, 41% e individëve të moshës 55 vjeç e sipër i besojnë policisë, krahasuar me 1 në 3 persona në moshë 36-55 vjeç (33%). 40% e personave të moshës 36-55 vjeç nuk i besojnë Policisë së Shtetit.

Niveli i Arsimit dhe Besimi: Edhe pse një në dy të anketuar (50%) me arsim fillor (8-9 vite shkollë) nuk kanë besim tek partitë politike, 44% e atyre me arsim të lartë shprehin të njëjtin mendim. Për më tepër, mungesa e besimit tek institucionet e kujdesit shëndetësor priret të ulet me rritjen e nivelit arsimor të të intervistuarve. 27% e individëve me arsim fillor nuk kanë besim tek institucionet shëndetësore, në krahasim me 29% me shkollë të mesme dhe 33% me arsim universitar.

Krahasimi me rajonin: Nëse do ta shohim çështjen nga perspektiva e rajonit do të vemë re se rezultatet e sondazhit të opinionit (të kryer me të njëjtin qëllim dhe metodologji) tregojnë se partitë politike janë institucioni më pak i besuar.






Perceptimet për Transparencën e Qeverisë dhe të Dhënat e Hapura

Besimi i qytetarëve tek institucionet publike dhe qeveria në përgjithësi është kryesisht rezultat i mënyrës së sjelljeve të këtyre institucioneve dhe qeverisë me zgjedhësit e tyre. Transparenca është thelbi i kërkesës së llogarisë së qytetarëve ndaj zyrtarëve publikë. Nuk ka një përkufizim të vetëm për transparencën apo të ndonjë metode për matjen e saj. Gjithsesi, për qëllimin e këtij Sondazhi të Opinioneve, transparenca ka kuptimin e praktikave aktive të të dhënave të hapura (dhënia e të dhënave publike, i informacionit për të ardhurat dhe pronat vetjake të zyrtarëve publikë, zbatimi dhe përdorimi i Ligjit për të Drejtën e Informimit).

Edhe pse të dhënat e vitit 2015 tregojnë se shoqëria shqiptare beson se qasja e të Dhënave të Hapura është mjaft e domosdoshme për nxitjen e transparencës së qeverisë, për rritjen e besimit të publikut dhe si bazë për zhvillim ekonomik dhe social, opinioni publik është i ndarë në qëndrimin e tij për sa i përket transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve shqiptare në punën e tyre të përditshme. 47% e qytetarëve të anketuar besojnë se institucionet publike shqiptare nuk janë transparente dhe të përgjegjshme⁷, ndërsa 41% e tyre besojnë se institucionet publike shqiptare janë transparente dhe të përgjegjshme.⁸ 12% nuk kanë asnjë opinion ose kanë refuzuar t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Për më shumë detaje shih Fig.7.

Fig. 7

Transparenca dhe llogaridhënia



Në lidhje me përqasjet e të dhënave të hapura, gjetjet tregojnë se një pjesë e mirë e qytetarëve i njohin përfitimet e të dhënave të hapura.

Pak më shumë se 9 në 10 shqiptarë të anketuar besojnë se politikat e të dhënave të hapura rrisin besimin e qytetarëve tek qeveria; vetëm 9% e të intervistuarve nuk janë dakord.⁹

Po ashtu, 92% besojnë se përqasjet e të dhënave të hapura forcojnë edhe marrëdhënien mes qeverisë dhe qytetarëve të saj (grupet e interesit); vetëm 8% nuk janë dakord.¹⁰

Fig. 8

Të dhënat e hapura e rrisin besimin e qytetarëve tek qeveria





Fig. 9

Të dhënat e hapura e forcojnë marrëdhënien e qeverisë me qytetarët dhe grupet e interesit



Në të njëjtën linjë, pjesa me e madhe ose 89% e të intervistuarve thonë se të dhënat e hapura të qeverisë mund të përmirësojnë jetën e njerëzve dhe 92% besojnë se politikat e të dhënave të hapura nxisin zhvillimin ekonomik.¹¹

Fig. 10

Të dhënat e hapura e përmirësojnë jetën e qytetarëve





Fig. 11


Të dhënat e hapura nxisin zhvillimin e ekonomisë



Gjithsesi, pavarësisht pranimet në përgjithësi të rëndësisë së të dhënave të hapura, rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe të shqiptarëve të pyetur (77%) nuk kanë paraqitur asnjëherë kërkesë zyrtare për të marrë informacion nga institucionet publike, krahasuar me 23% të atyre që e kanë bërë një gjë të tillë..

Fig. 12

A keni dorëzuar ndonjëherë një kërkesë zyrtare për të marrë informacion apo të dhëna nga institucionet shtetërore?



Po ashtu, të anketuarve iu dhanë një sërë pohimesh për transparencën në lidhje me politikat konkrete apo rregullat e procedurës dhe iu kërkua të vlerësonin miratimin apo mosmiratimin e tyre me secilën prej tyre. Në Fig. 13 jepet një përmbledhje grafike e këtyre përgjigjeve.


Pjesa më e madhe apo 79% e të anketuarve mbështesin fuqimisht praktikën që informacioni për kontratat e punëve publike dhe investimeve të financuara nga qeveria të bëhet publik.

Për më tepër, 64% janë të mendimit se zyrtari publik që “rrjedh” informacionin e klasifikuar të qeverisë duhet të ndëshkohet.¹²

8 në 10 qytetarë të intervistuar nuk janë aspak dakord me pohimin se politikanët, deputetët dhe zyrtarët e zgjedhur vendorë duhet ta mbajnë sekret informacionin mbi të ardhurat personale dhe pasurinë e tyre. Një tjetër rezultat i rëndësishëm për t’u parë është se 77% e të anketuarve janë krejtësisht kundër praktikave të rekrutimit ku kërkohet informacion për origjinën etnike dhe besimin fetar.

Fig. 13

Transparenca 2015



Shënim: Përgjigjet “nuk kam opinion” nuk paraqiten këtu.

Rezultatet e përgjithshme tregojnë se mbi ¾ e shoqërisë shqiptare në përgjithësi kërkon zbatimin e politikave dhe përjasjeve të të dhënave të hapura, me besimin se ky është mekanizmi që kontribuon shumë në qeverisjen e mirë dhe në ngushtimin e hendekut mes qeverisë dhe qytetarëve. Praktika të tilla i pajisin qytetarët me njohuritë e nevojshme për t'u angazhuar aktivisht në kërkesën e llogarisë për qeverinë. Qytetari i pajisur me informacione për qeverinë është në gjendje të bëjë pyetjet e sakta dhe të kuptojë përparësitë e qeverisë. Këto të dhëna kërkojnë nga qytetarët e angazhuar, gazetarët dhe aktorët e tjerë.

Krahasimi kohor: Analiza krahasuese tregon se për tretin vit radhazi (2013-2015) mund të dallohet një rritje e qëndrueshme e mbështetjes së publikut për pohimin “I gjithë informacioni teknik dhe i performancës financiare për kontratat e financuara nga qeveria duhet të bëhet publik”.

Perceptimi i korrupsionit në institucionet publike

Transparency International e përkufizon përgjithësisht korrupsionin si abuzimi i pushtetit të besuar për përfitime private. Kjo mund të ndodhë kudo dhe mund të klasifikohet si korrupsion i madh ose i vogël, në varësi të shumës së parave të përvetësuara dhe të sektorit ku ndodh ky korrupsion.

Për qëllimin e këtij Sondazhi të Opinionit, korrupsioni konsiderohet kur ndodh në institucionet publike (në qeverinë qendrore dhe njësitë vendore), të cilat në punën e tyre përdorin fondet publike dhe ofrojnë shërbime me motivimin për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe jo për të gjeneruar fitime. Në bazë të këtij vlerësimi, çdo abuzim me pushtetin e besuar për përfitime private që ndodh tek organet e qeverisjes qendrore e vendore konsiderohet si korrupsion në sektorin publik. Disa nga format më të zakonshme të korrupsionit në institucionet publike, të përkufizuara nga Transparency International, janë:


- **Vjedhja** – kur një person që mban poste në një institucion, organizatë ose kompani, në mënyrë të pandershme dhe të paligjshme përvetëson, përdor e trafikon fondet dhe pasuritë që i janë besuar për pasurimin personal apo aktivitete të tjera
- **Patronazhi** – forma e favorizimit me të cilën zgjidhet një person, pavarësisht kualifikimeve apo plotësimit të kriterëve, për një vend pune apo përfitime në qeveri për shkak të lidhjeve apo përkatësisë politike
- **Nepotizmi** – formë e favorizimit sipas njohjeve dhe lidhjeve familjare, ku dikush në post zyrtar shfrytëzon pushtetin dhe autoritetin e tij për të siguruar një vend pune apo favore për një anëtar të familjes apo shok edhe pse ai apo ajo mund të mos jetë i/e kualifikuar apo ta meritojë atë.

- **Konflikt i interesit** – situatë ku një individ apo subjekt për të cilin punojnë, qoftë qeveria, biznesi, media apo organizatë e shoqërisë civile, përballet me zgjedhjen mes detyrave dhe kërkesave të postit të tyre dhe interesave të tyre private.
- **Shkeljet në prokurim** – proces me shumë faza të procedurave të përcaktuara për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga individë, kompani apo organizata – nga vlerësimi paraprak i nevojave deri tek dhënia e kontratës dhe lëvrimi i shërbimit/mallit
- **Shantazhi** – veprimi i marrjes së parave apo i detyrimit të njerëzve për të diçka me anë të kërcënimit të nxjerrjes së një sekreti të tyre apo dëmtimit të tyre.

Në këtë drejtim, qytetarët u pyetën nëse kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti korrupsioni në institucione publike në nivel qendror ose vendor ku ata jetojnë.

Fig. 14

A keni qenë ju personalisht dëshmitar i ndonjë rasti korrupsioni të ndodhur në institucionet publike?




Për sa i përket nivelit qendror të qeverisjes, ndërsa afro 1 në 3 shqiptarë të anketuar (34%) raportojnë se kanë qenë dëshmitarë të një rasti korrupsioni, një pjesë edhe më e madhe e qytetarëve (53%) thonë se nuk kanë parë një rast të tillë. Ndërkohë, 13% zgjedhën të mos i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përballja personale me korrupsionit është më e lartë në qeverinë vendore, d.m.th., në bashkitë ku jetojnë qytetarët. Në mënyrë të veçantë, shumica e të anketuar ose 41%

raportojnë se kanë qenë dëshmitarë të një rasti korrupsioni në bashkinë e tyre, ndërsa 34% nuk raportojnë një përvojë të tillë. 1 në 5 persona apo 25% kanë zgjedhur të mos i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Fig. 15

A keni qenë ju personalisht dëshmitar i ndonjë rasti korrupsioni të ndodhur në bashkinë tuaj?



Një nga interpretimet që mund të shpjegojë numrin më të lartë të të anketuarve që pretendojnë të kenë parë një rast korrupsioni në bashkinë e tyre mund të jetë fakti se kjo anketë është kryer në rang vendi - duke përdorur kuota sipas ndarjes administrative (61 bashki). Qytetarët që banojnë në qytete apo fshatra jashtë kryeqytetit pritet të kenë më shumë kontakte me qeverinë vendore sesa me qeverinë qendrore.

Një tjetër arsye e mundshme mund të jetë se bashkia si njësi e qeverisjes vendore ofron shërbime më të drejtpërdrejta për qytetarët, krahasuar me institucionet e qeverisë qendrore.

Gjinia dhe Korrupsioni: Statistikat relacionale sugjerojnë se nuk ka ndryshim të dukshëm në përballjen me korrupsionin në nivel vendor e qendror mes gjinive.


Mosha dhe Korrupsioni: Megjithatë, qytetarët e moshës 18-35 vjeç janë grupmosha me më shumë gjasa të raportojnë përvojën e tyre personale me korrupsionin në bashki apo në nivel qendror (46% dhe 40%) në krahasim me grupmoshat 36-55 vjeç (31% dhe 30%) dhe ata 55 vjeç e sipër (30% dhe 22%).

Të dy grupet e të intervistuarve, si ata që kishin qenë dëshmitar të një rasti korrupsioni dhe ato që nuk kishin parë gjë, iu kërkua të përmendnin disa nga format më të zakonshme

të korrupsionit në institucionet publike (që mund të kenë marrë vesh, të kenë dëgjuar, lexuar apo prej të cilit të jenë ndikuar). Në të dy nivelet e qeverisjes, qendrore dhe vendore, përvetësimi (abuzimi me/ose vjedhje të fondeve publike) duket se është forma më e zakonshme e korrupsionit që ndodh. Në anën tjetër, patronazhi dhe shantazhi janë dy forma më pak të pranishme të korrupsionit, siç perceptohet nga qytetarët.

Fig. 16

Format më të zakonshme të korrupsionit



Perceptimet për angazhimin e qytetarëve me qeverinë

Angazhimi Qytetar është një nga shtyllat kryesore të qeverisjes së hapur; është lidhja jetike mes transparencës dhe llogaridhënies. Partneriteti për Qeverisje të Hapur¹³ kërkon hapjen ndaj pjesëmarrjes së qytetarëve dhe angazhimin e tyre në hartimin e politikave dhe në qeverisje, përfshirë këtu edhe mbrojtjen bazë të lirive civile. Në një botë gjithnjë e më komplekse, mendimi i qytetarëve kthehet në një burim tepër të rëndësishëm për hartimin e politikave. Vendimmarrja e mirë ka nevojë për njohuritë, përvojat, pikëpamjet dhe vlerat e publikut. Zbatimi i vendimeve të vështira varet nga pranimi dhe mbështetja e qytetarëve.


Nëse qytetarët nuk i kuptojnë dhe nuk janë të angazhuar me vendimet, besimi humbet lehtësisht (OECD, 2009).¹⁴

Njerëzit në mbarë botën kanë treguar vazhdimisht se nuk janë të kënaqur me angazhimin me qeverinë vetëm përmes zgjedhjeve periodike. Prandaj, është e rëndësishme që angazhimi qytetar të programohet mirë dhe të ketë burimet e nevojshme dhe që lind nga dëshira e vërtetë për të përfshirë publikun e për të marrë parasysh mendimin dhe kontributin e tij. Angazhimi i mirë qytetar mund të mbështesë funksionimin efektiv të demokracisë, legjitimitetin e qeverisë, zbatimin me sukses të politikave dhe arritjen e rezultateve sociale. Praktikrat e dobëta të angazhimit mund të çojnë në vendime të dobëta dhe apati të qytetarëve (Brodie et al, 2011).¹⁵

Sipas diskutimeve të mësipërme, qytetarët u pyetën nëse janë dakord apo jo me pesë pohimet që lidhen me angazhimin qytetar me qeverinë.

Fig. 17

Pjesëmarrja e qytetarëve



Shënim: Përgjigjet "nuk kam opinion" nuk paraqiten këtu.

Edhe pse besojnë se kanë njohuri të mjaftueshme për të gjykuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq për shoqërinë shqiptare, qytetarët nuk duket se besojnë në efikasitetin e mekanizmave që mundësojnë angazhimin e tyre në hartimin e politikave dhe në vendimmarrje, duke ia dhënë kështu Parlamentit autoritetin për hartimin e politikave publike dhe kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë.


Të pyetur për mendimin e tyre për pohimin “Qytetari nuk ka njohurinë e duhur për të gjykuar nëse vendimet e qeverisë janë të drejta apo të gabuara”, 62% e shqiptarëve të anketuar nuk janë dakord me të. Megjithatë, fakti që 32% e të anketuarve janë dakord me këtë pohim përbën një çështje shqetësuese. Nëse qytetarët nuk kanë besim në aftësitë e tyre për vlerësimin e politikave, rrjedhimisht ata nuk mund të kenë besim në vetvete për t’i kërkuar llogari qeverisë në lidhje me hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave.

Gjetjet evidentojnë një nivel shqetësues të apatisë që karakterizon shoqërinë shqiptare në lidhje me angazhimin e saj me qeverisjen e të dy niveleve. Një nga arsyet e ndjenjës së “apatisë” mund të jetë rrethi vicioz i mungesës së besimit në të cilën gjenden të bllokuar qytetarët dhe institucionet publike.

Më konkretisht, edhe pse 36% besojnë se Parlamenti është i hapur për konsultime me shoqërinë civile dhe grupet e interesit gjatë seancave dëgjimore, 43% besojnë se mendimi dhe sugjerimet që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit nuk merren parasysh.

Fig. 18

Sugjerimet e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit mbi draft ligjet merren në konsideratë nga Parlamenti



Në të njëjtën linjë, në lidhje me qeverisjen vendore, 61% e të intervistuarve besojnë se “Dëgjesat me publikun që bëhen në këshillat e bashkive janë vetëm formale dhe nuk ndikojnë në vendimet që marrin bashkitë.” Kjo është çështje me rëndësi të jashtëzakonshme, që duhet të merret në shqyrtim të mëtejshëm nga institucionet përkatëse (qeveria, OShC, donatorët, etj.).


Niveli i ulët i besimit tek kanalet e komunikimit të qeverisë me publikun në lidhje me hartimin e politikave dhe vendimmarrjen si dhe përbindja e konsiderueshme e qytetarëve që nuk kanë besim tek aftësitë e tyre për të luajtur rol aktiv në qeverisjen e vendit (më pak se 1 në 3 qytetarë ose 32%) duket se e ka bërë që shoqëria shqiptare ta transferojë këtë pushtet tek Parlamenti. Si rezultat, 80% e të intervistuarve besojnë se deputetet duhet të marrin përsipër përgjegjësinë e qytetarëve në formësimin e politikave publike.

Kapërcimi i apatisë së publikut dhe përgjigja me efektivitet për qytetarët kërkon ndryshim të kulturës në mënyrën e ndërveprimit dhe bashkëpunimit të qeverisë me publikun. Edhe pse ka një rritje të konsiderueshme të përdorimit të internetit dhe numrit të faqeve qeveritare apo të tjera, si forume, rezultatet tregojnë se qytetarët (52% e të anketuarve) mendojnë se diskutimet dhe komentet në internet nuk përfaqësojnë siç duhet opinionin publik.

Nga ana tjetër, ka rëndësi të vëmë në pah se pjesëmarrja në demonstrata apo nënshkrimi i peticioneve konsiderohet si instrument i rëndësishëm për kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. 4 në 10 shqiptarë të anketuar (ose 40%) pranojnë se janë angazhuar personalisht në një nga këto veprimtari të tilla.

Fig. 19

A keni marrë pjesë në ndonjë protestë / tubim apo keni nënshkruar ndonjëherë ndonjë peticion



Gjinia dhe Angazhimi qytetar: Analiza nxjerr në pah se meshkujt (47%) kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në demonstrata apo në nënshkrimin e peticioneve në krahasim me femrat (34%).

Mosha dhe Angazhimi qytetar: Pjesëmarrja priret të ulet me moshën (45% për grupmoshën 18-35 vjeç, 38% për grupmoshën 36-55 vjeç, dhe 31% për grupmoshën mbi 55 vjeç).

Krahasimi kohor: Analiza krahasuese tregon se për të tretin vit radhazi ka një rënie në përqindjen e qytetarëve të anketuar që thonë se “Dëgjuesat me publikun që bëhen në këshillat e bashkive janë vetëm formale dhe nuk ndikojnë në vendimet që marrin bashkitë” (nga 65% në 63% në 61%).


Perceptimet për llogaridhënien e qeverisë

Nocioni i llogaridhënies është koncept amorf dhe i vështirë për t’u kufizuar në terma të saktë. Sipas Bankës Botërore¹⁶, llogaridhënia ekziston kur ka një marrëdhënie ku individ apo subjekti dhe kryerja e detyrave apo funksioneve nga ai individ apo subjekti i nënshtrohet mbikëqyrjes, drejtimit apo kërkesës së dikujt tjetër për të dhënë informacione apo arsye për veprimet e tij. Koncepti i llogaridhënies mund të klasifikohet sipas llojit të llogaridhënies së ushtruar dhe/ose personit, grupit apo institucionit ku jep llogari zyrtari publik. Debati i sotshëm në lidhje me përmbajtjen e formave të ndryshme të llogaridhënies konceptohet më mirë duke iu referuar kundërshtimit të formave të llogaridhënies, duke njohur dy forma kryesore: llogaridhënia horizontale dhe llogaridhënia vertikale. “Llogaridhënia horizontale është kapaciteti i institucioneve shtetërore për të mbajtur nën kontroll abuzimet nga agjencitë tjera publike dhe degë të qeverisë, apo detyrimin e agjencive për të raportuar.” Mund ta vëmë re rritjen e llogaridhënies administrative me krijimin e institucionit të Avokatit të Popullit si dhe ekzistencën e inspektorateve të pavarura, auditorëve, organeve mbikëqyrëse, etj. Nga ana tjetër, llogaridhënia vertikale është nga mekanizmi, i cili u mundëson qytetarëve, gazetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të kërkojnë zbatimin e standardeve të performancës së mirë tek zyrtarët¹⁷. Llogaridhënia sociale, nga ana tjetër, është një qasje (disa mekanizma të krijuar) drejt ndërtimit të llogaridhënies që mbështetet në angazhimin qytetar, përkatësisht kur qytetarët dhe/ose organizata të shoqërisë civile marrin pjesë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në kërkesën e llogarisë. Mekanizmat e përgjegjësisë sociale mund të nisen dhe mbështeten nga shteti, qytetarët ose të dy bashkë, por shumë shpesh ata nxiten nga kërkesa dhe veprojnë vullnetarisht.

Për qëllimin e këtij sondazhi, qytetarëve iu kërkua të jepnin opinionin e tyre sa efikase dhe funksionale janë mekanizmat e llogaridhënies (horizontale dhe vertikale) për ta bërë qeverinë qendrore të japë llogari për veprimet e saj.

Fig. 20

Mekanizmat e llogaridhënies horizontale



Në lidhje me mekanizmat e llogaridhënies horizontale, 79% e qytetarëve të anketuar besojnë se Parlamenti është institucioni me ndikimin më të madh që mund ta bëjë qeverinë të japë llogari tek shoqëria. Më pas vijnë deputetët individualë me 73%.

Sa i përket rolit të Avokatit të Popullit, perceptimi publik duket se ndahet në ata që besojnë se Avokati i Popullit ka një ndikim në llogaridhënien e qeverisë (45%) dhe atyre që perceptojnë se ky institucion nuk ka një ndikim të tillë (49%). Duke pranuar rolin shumë të rëndësishëm që mund të luajë ky institucion në sistemin institucional të “kontrollit dhe ruajtjes së balancës”, kjo gjetje sugjeron se duhet më shumë ndërgjegjësim për rolin e këtij institucioni.

Në lidhje me mekanizmat e llogaridhënies vertikale, organizatat ndërkombëtare (si BE dhe NATO) janë me ndikimin më të lartë të perceptuar në llogaridhënien e qeverisë, me 74% të qytetarëve të intervistuar që janë dakord me këtë. Në ekstremin tjetër, vetëm 35% e të anketuarve besojnë se organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri mund të bëjnë që qeveria të japë llogari. Këto rezultate korrespondojnë me rezultatet e besimit tek institucionet ku NATO dhe BE besohen nga 74% dhe 72% e qytetarëve, ndërsa organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri nga vetëm 38% e qytetarëve.

Krahasimi kohor: Rezultatet tregojnë se në krahasim me vitin 2014, të tre institucionet e perceptuara se kanë një rol në rritje në llogaridhënien e qeverisë janë media (nga 42% në 58%), organizatat e shoqërisë civile (nga 20% në 35%) dhe nga Parlamenti (nga 65% në 79%).¹⁸



Fig. 21

Avokati i Popullit




Fig. 22

Mekanizmat vertikalë të llogaridhënies





Fig. 23

Ndryshimi në ndikimin tek mekanizmat e llogaridhënies (p.p.)
2014-2015



Perceptimet për TIK dhe qeverisjen e mirë


Për qeverisjen e mirë, transparenca është me shumë rëndësi, por po kaq rëndësi kanë edhe angazhimi dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve. Kohët e fundit, në të gjithë botën, teknologjia ka transformuar marrëdhënien mes qeverive dhe qytetarëve. Interneti ka pasur efekt demokratizues. Ai jo vetëm që fuqizon qytetarët dhe pjesëmarrjen e tyre, por edhe ka ndihmuar qeveritë për të kuptuar e për të trajtuar nevojat e vërteta të qytetarëve. Megjithatë, përdorimi i mundësive që sjell teknologjia për përhapjen e informacionit është vetëm gjysma e ekuacionit. Të gjitha këto marrin shpërblim nëse qytetarët, shoqëria civile dhe bizneset e përdorin këtë informacion për të monitoruar ecurinë, për t'u kërkuar llogari atyre që marrin vendime dhe, ku është e nevojshme, për të inkurajuar ndryshimin. Është me rëndësi jetike që të dy nivelet e qeverisjes të sigurojnë mjetet e nevojshme për përdorimin e këtyre të dhënave dhe mundësive që sjell teknologjia për të pasur ndikim pozitiv në jetën e njerëzve dhe në komunitet.¹⁹

Të dhënat e vitit 2015 tregojnë se pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar (65%) besojnë se TIK mund të përmirësojë qeverisjen, ndërsa 1 në 5 qytetarë (25%) nuk janë në dijeni ose nuk kanë informacionin e nevojshëm për mundësitë që ofron TIK në forcimin e qeverisjes së mirë.

Për më tepër, analizat relacionale tregojnë se ky besim është më i pranishëm tek të rinjtë dhe qytetarët e mirë-arsimuar.

Fig. 24

A mendoni se përdorimi i teknologjisë së informacionit mund të përmirësojë qeverisjen?




Mosha dhe roli i TIK: Për shembull, ndërsa 71% e qytetarëve të grup-moshës 18-35 vjeç thonë se TIK mund të forcojë qeverisjen e mirë, kjo përqindje bie në 62% për grup-moshën 36-55 vjeç, dhe në 50% për ata të moshës 55 vjeç e sipër.

Arsimi dhe roli i TIK: Për sa i përket nivelit arsimor, ky pohim miratohet nga 76% e atyre me diplomë universitare dhe 61% me shkollë të mesme. Përqindja bie menjëherë në 39% tek të anketuarit që kanë vetëm arsimin e detyrueshëm. Nuk ka dallime të dukshme në përgjigjet sipas gjinisë.

Nga ana tjetër, pavarësisht njohjes së përfitimeve të mundshme të përdorimit të TIK-ut, duket se qytetarët nuk përdorin TIK-un si një nga mjetet për t'u lidhur me njësinë e tyre të qeverisjes vendore (bashkinë). Kur u pyetën nëse bashkia ku jetojnë ka një faqe interneti apo jo, 48% e të anketuarve thanë se nuk e dinin. Megjithatë, statistikatat relacionale sugjerojnë se kjo çështje mund të jetë objekt i paragjyqimeve sociale. Të intervistuarit kanë pohuar ekzistencën e faqeve të internetit edhe në rastet kur bashkia e tyre nuk kanë një faqe të tillë. Ata mund të jenë ngatërruar për ekzistencën e adresës në internet me llogari të tjera të mediave sociale. Disa bashki nuk kanë faqe internetit, por llogari zyrtare në Facebook.²⁰

Fig. 25

A ka Bashkia ku ju banoni faqe interneti?




Në ato raste kur qytetarët janë në dijeni se bashkia e tyre ka një faqe në internet, mënyra më e zakonshme e përdorimit të faqes është për “të parë programet dhe ngjarjet në qytet”, siç deklarohet nga 56% e të intervistuarve.²¹

Megjithatë, kur u pyetën për të vlerësuar shpeshhtësinë e frekuentimit të faqes ueb, vetëm 11% raportuan se e vizitonin faqen rregullisht (shumë shpesh). Format më pak të përdorura të komunikimit janë “komunikimi me zyrtarët e bashkisë” dhe “dërgimi i dokumenteve apo formularëve online ose me email”, siç konfirmohet nga 23% e atyre të anketuar.

Fig. 26

Format e përdorimit të TIK për të komunikuar me bashkinë




Krahasimi kohor: Analiza krahasuese tregon se ka një rritje të ndërgjegjësimit për përdorimin e TIK si mjet komunikimi me përfaqësues të bashkisë, siç tregohet edhe nga rënia e përqindjes së të anketuarve që thonë se nuk e dinë që bashkia e tyre ka një faqe në internet. Shih Fig. 27.

Po ashtu, edhe përqindja e qytetarëve të anketuar që thonë se përdorin mjetet TIK (email) për të dërguar ankesa tek zyrat përkatëse në bashkinë e tyre është rritur në mënyrë të

Fig. 27


% e të intervistuarve që nuk e dinë nëse bashkia e tyre ka faqe në internet



konsiderueshme që nga viti 2013. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht nga rritja e përdorimit të telefonave inteligjentë dhe përhapjes së medias sociale si mjet komunikimi. Për më shumë, shih Fig. 28.

Fig. 28

% e atyre që kanë dërguar ankesa tek bashkia



Perceptimi për performancën e institucioneve publike

Sektori publik luan një rol të rëndësishëm në shoqëri. Sektori publik përcakton, zakonisht përmes një procesi politik, rezultatet që dëshirojnë të arrijnë dhe llojet e ndryshme të ndërhyrjes. Këtu përfshihen miratimi i ligjeve apo rregulloreve, ofrimi i mallra dhe shërbimeve, rishpërndarja e të ardhurave nëpërmjet mekanizmave të tilla si tatimet apo pagesat e sigurimeve shoqërore, dhe pronësia e aseteve ose subjekteve, si ndërmarrjet shtetërore. Qeveritë luajnë një rol edhe në promovimin e drejtësisë, paqes dhe rendit dhe marrëdhënive të shëndetshme ndërkombëtare. Qeverisja efektive në sektorin publik inkurajon vendimmarrje më të mirë dhe përdorimin efikas të burimeve si dhe forcon kërkesën e llogarisë për administrimin e këtyre burimeve. Qeverisja efektive karakterizohet nga kontrolli i kujdesshëm, i cili ushtron presion të rëndësishëm për përmirësimin e performancës së sektorit publik dhe për luftën kundër korrupsionit. Qeverisja efektive mund të përmirësojë menaxhimin, duke mundësuar zbatimin me më shumë efektivitet të ndërhyrjeve të zgjedhur, shërbime më të mira, dhe, së fundi, rezultate më të mira. Në këtë mënyrë përmirësohet edhe jeta e njerëzve.²²

Qytetarëve iu kërkua të vlerësonin performancën e një sërë institucionesh në një shkallë prej 1 (shumë dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm). Për analizën e kësaj pyetje, përgjigjet e ngjashme janë mbledhur bashkë, d.m.th., kategoria “punë e shkëlqyer/shumë e mirë” për të përfaqësuar parametrin “e mirë” dhe kategoria “shumë dobët/dobët” për të përfaqësuar parametrin “dobët”.

Të dhënat e vitit 2015 tregojnë se tre institucionet me renditjen më të lartë për performancën e tyre janë institucionet fetare, policia, dhe forcat e armatosura, të cilat vlerësohet pozitivisht përkatësisht nga 29%, 23% dhe 22% e qytetarëve të intervistuar. Performanca e qeverisë qendrore dhe asaj vendore vlerësohet si e mirë nga e njëjta përqindje e shqiptarëve të anketuar (14% dhe 13%). Në Fig. 29 jepet një zbirim i rezultateve për grupin e institucioneve.

Nuk është për t'u habitur që institucionet me vlerësimin më të ulët në opinionin publik në lidhje me performancën e tyre në vitin 2015 janë gjyqësori (me 67% të të anketuarve që thonë se gjyqësori po punon shumë dobët) dhe partitë politike (me 63% e të anketuarve që thonë se partitë politike punojnë shumë dobët). Më shumë se 1 në 2 të intervistuar (55%) mendojnë se Parlamenti ka performancë të dobët.

Për sa i përket qeverisë, në Fig. 30 jepet një pamje e hollësishme grafike.

Fig. 29

Si e vlerësoni kryerjen e funksioneve kryesore të këtyre institucioneve?





Fig. 30


Kryerja e funksioneve kryesore: Qeveria



Edhe pse ka një perceptim të përgjithshëm se institucionet publike (ato që mbulohen nga ky sondazh) kanë performancë jo të mirë në kryerjen e funksioneve të tyre bazë, rreth $\frac{3}{4}$ e të intervistuarve (ose 71%) besojnë se institucionet publike mund të përmirësojnë performancën e tyre.

Fig. 31

A mendoni se institucionet publike në Shqipëri mund të kryejnë funksionet e tyre më mirë?



Nga ana tjetër, 18% mendojnë se nuk kanë besim në aftësinë e institucioneve të lartpërmendura për të përmirësuar kryerjen e funksioneve të tyre kryesore. Kur u pyetën për të vlerësuar pengesat e mundshme, rreth 8 në 10 qytetarë i konsiderojnë “Politika punësimi jo – transparente dhe jo të rregullta”, “Stafi nuk është i kualifikuar” dhe “Ndërhyrjet politike/ ndryshimet e shpeshta të stafit” si pengesat kryesore për përmirësimin e tyre. Më shumë rezultate jepen në tabelën 3.

Tabela 3: Pengesa të rëndësishme për përmirësimin e performancës së institucioneve publike

	Pengesa të rëndësishme për përmirësimin e performancës së institucioneve publike
Politika punësimi jo – transparente dhe jo të rregullta	83%
Nuk ka vullnet	70%
Stafi nuk është i kualifikuar	81%
Ndërhyrjet politike / ndryshimet e shpeshta të stafit	79%
Mungesë kapacitetesh infrastrukturore	71%
Mungesë vizioni dhe vazhdimësie	70%

Ndikimi politik në punën e institucioneve publike

Ndërhyrja e politikës në punën e përditshme të këtyre organeve u identifikua si një nga pengesat për përmirësimin e performancës së institucioneve publike (shih tabelën më lart). Kjo çështje u shqyrtua më tej dhe qytetarët u pyetën nëse, sipas mendimit të tyre, interesat politike ndërhynë në punën e institucioneve publike. Sipas kuptimit të këtij Sondazhi të Opinioneve, ndikimi politik konsiderohet veprimet rregullator të ndërmarra nga qeveria në mënyrë që të ndikojë ose të ndërhijë tek vendimet e marra nga individët, grupet ose organizatat në lidhje me çështjet sociale dhe ekonomike.


Gjetjet tregojnë se gjyqësori (59% e qytetarëve të anketuar) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (55% e qytetarëve të anketuar), por në nivel të konsiderueshëm edhe Policia (48%), institucionet e sistemit shëndetësor (46%) dhe institucionet e sistemi arsimor (45%) perceptohen si mjaft të cënueshëm ndaj ndikimit politik.

Institucionet fetare perceptohen si më të pavarur (mes institucioneve që të marrë në këtë studim). 62% e të anketuarve besojnë se politika nuk ka ndikim tek këto institucione.

Në Fig. 32 jepet një pamje e detajuar e përgjigjeve.

Fig. 32


Ndikimi politik në punën e institucioneve publike 2015



Krahasimi kohor: Analiza krahasuese tregon se ka një rënie të dukshme në ndikimin e perceptuar të politikës në punën e institucioneve publike të përzgjedhura. Krahasuar me vitin 2014, institucioni që ka parë rritjen më të madhe në pavarësinë nga ndikimi politik është Policia (nga 59% në 48%).²³ Për më tepër shih Fig.33.

Fig. 33

Ndryshimi në ndikimn politik (p.p.)
2014-2015



Perceptime për konsideratat gjinore në lidhje me politikat publike


Qytetarëve iu kërkua që të japin mendimin e tyre për tre pohimet kryesore të lidhura me gjininë, duke u fokusuar në (1) aksesin tek shërbimet publike, (2) diskriminimin gjinor, dhe (3) çështja gjinore në politikat publike. Gjatë analizimit e këtyre gjetjeve të lidhura me gjininë, ajo që vihet re është se nuk ka dallime të dukshme në perceptimin mes burrave dhe grave (për sa i përket këtyre tre pohimeve).

Nëse do t'u hyjmë më shumë detajeve, rezultatet tregojnë se 52% e të anketuarve (të përgjigjet e përmbledhura të “jam plotësisht dakord” dhe “jam dakord”) besojnë se nuk ka diskriminim të dukshëm mes grave dhe burrave në aksesin tek shërbimet publike. 20% e të anketuarve nuk janë dakord me këtë pohim.

Pohimi 1: Burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike

Fig. 34

Burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike




Kur shqyrtojmë dallimet mes përgjigjeve të dhëna nga meshkujt dhe femrat, ajo që mund të vërehet është se shumë gra prirën të thonë “jam dakord” dhe shumë meshkuj kanë tendencë të thonë “Jam shumë dakord” me këtë pohim. Megjithatë, ajo që duket gjithashtu shqetësuese është se mesatarisht 24% e të anketuarve janë asnjans dhe 24% nuk janë dakord, gjë që mund të tregojë një perceptim të fortë aksesit të njëanshëm gjinor tek shërbimet.

Pohimi 2: Nëpunësit civilë iu shërbejnë me të njëjtën gatishmëri dhe etikë si burrave dhe grave

Rezultatet tregojnë se 50% e të intervistuarve besojnë se ky pohim është i vërtetë. Kur zbërthejmë të dhënat sipas gjinisë, rezultatet tregojnë se ky pohim mbështetet nga pak a shumë njësoj si nga meshkujt (51.1%) ashtu edhe femrat (50.3%).

Fig. 35

Nëpunësit civilë iu shërbejnë me të njëjtën gatishmëri dhe etikë si burrave dhe grave




Pohimi 3: Çështjet gjinore në politikat publike

Vetëm 37% e popullsisë besojnë se dallimet dhe nevojat gjinore merren parasysh nga institucionet publike kur gjatë hartimit të politikave dhe programeve.

Fig. 36

Institucionet publike marrin parasysh nevojat gjinore gjatë hartimit të programeve dhe politikave



Ajo që ka rëndësi të theksohet është se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë (22%) nuk ka një opinion apo qëndrim në lidhje me çështjet gjinore në hartimin e politikave publike. Për më tepër, 40% besojnë se çështje të tilla nuk merren fare parasysh, duke evidentuar një mjedis mjaft të rëndë për zhvillim e balancuar gjinor.

Kënaqshmëria me Ofrimin e Shërbimeve Publike

Mundësia e përmirësimit të shërbimit publik për të kontribuar në rikthimin e besimit tek qeveria mbetet çështje për t'u debatuar.²⁴ Megjithatë, ka evidenca të mjaftueshme empirike që nxjerrin në pah se kënaqshmëria dhe besimi kanë bashkëlidhje pozitive. Prandaj, shumë qeveri kanë hartuar programe për rivendosjen dhe rritjen e besimit në këto institucione. Ideja që qëndron në themel të tyre është se rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike do të rrisë kënaqshmërinë me sektorin publik, gjë që rrjedhimisht do të rrisë nivelin e besimit tek qeveria (Bouckaert dhe Van de Walle 2003)²⁵.

Duke u mbështetur në këtë supozim, pyetja e fundit në Sondazhin e Opinionit kishte si synim matjen e nivelit të kënaqshmërisë me shërbimet publike të ofruara nga disa institucione qeveritare. Shërbimet e përzgjedhura publike janë ato që qytetarët marrin çdo ditë (p.sh., transporti publik) apo mjaft shpesh (d.m.th., shërbimet shëndetësore, shërbimet komunale) të ofruara si nga qeveria qendrore ashtu edhe ajo vendore.

Në pak fjalë, gjetjet sugjerojnë se përqindja e qytetarëve të anketuar të cilët janë të pakënaqur me cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike është më e lartë se përqindja e atyre të kënaqur.

Gjetjet tregojnë se qytetarët janë më së shumti të kënaqur me shërbimet e urgjencës (zjarrfikësit, policia, etj.) dhe shërbimeve komunale (të ofruara në nivel vendor), me 38% dhe 34% të të intervistuarve, përkatësisht.

Nga ana tjetër, më shumë se gjysma e qytetarëve nuk janë të kënaqur me shërbimin e punësimit (59%), me shërbimin e gjyqësorit (56%) dhe me shërbimin shëndetësor (53%).


Analizat e hollësishme të lidhjes mes gjinisë dhe kënaqshmërisë me shërbimet publike tregojnë se në përgjithësi (në lidhje me shërbimet e marra në këtë studim) nuk ka ndryshime të dukshme mes meshkujve dhe femrave dhe nivelit të tyre të kënaqshmërisë.

Gjinia dhe kënaqshmëria me shërbimet publike: Megjithatë, nëse do t'i hedhim një një vështrim më nga afër, të dhënat tregojnë se meshkujt priren të jenë më të pakënaqur me shërbimet sociale sesa të intervistuarat femra. Në mënyrë të veçantë, 41% e meshkujve shprehen se janë të pakënaqur me ofrimin e shërbimeve sociale në krahasim me 33% të femrave në studim.²⁶ Përveç kësaj, meshkujt janë më pak të prirur të jenë të kënaqur me shërbimet gjyqësore sesa femrat. 60%²⁷ e meshkujve janë të pakënaqur me ofrimin e shërbimit gjyqësor në krahasim me 49% të femrave.

Mosha dhe kënaqshmëria me shërbimet publike: Në lidhje me moshën, analiza relacionale nuk tregon ndryshime në pakënaqësinë me shërbimin e sistemit shëndetësor sipas moshës. Por, të rinjtë e intervistuar mbeten më pak pozitivë me pikëpamjet e tyre rreth performancës së universiteteve publike sesa individët më të vjetër në moshë të këtij sondazh: 38%²⁸ e individëve të moshës 18-35 vjeç janë të pakënaqur me universitetet publike, në krahasim me 33% të individëve të moshës 36-55vjeç dhe 23% të individëve të moshës 55 vjeç e sipër.

Fig. 37

Sa i kënaqur jeni me cilësinë dhe profesionalizmin e ofrimit të shërbimeve publike




Shënim: Përgjigjet "nuk kam opinion" nuk paraqiten këtu.

Krahasimi kohor: Analiza krahasuese tregon se tre institucionet që kanë pësuar ndryshim pozitiv në nivelin e kënaqshmërisë janë shërbimet komunale (nga 31% në 34%), shërbimet e urgjencës (nga 36% në 38%) dhe transporti publik (nga 28% në 30%). Nga ana tjetër, shërbimi shëndetësor (nga 37% në 20%) dhe shërbimi arsimor (nga 42% në 26%) janë dy institucione që kanë përjetuar rënien më të madhe në nivelin e kënaqshmërisë për vitin 2015.²⁹

Fig. 38


Ndryshimi në kënaqshmërinë me shërbimet publike (p.p.)
2014-2015



Gjatë analizimit të lidhjes mes nivelit të kënaqësishtëmërisë dhe të besimit për tre institucionet, përkatësisht shëndetësinë, arsimin dhe gjyqësorin, të dhënat tregojnë se kënaqëshmëria dhe besimi shkojnë dorë për dorë. Gjetje mjaft interesante që mund të bëjnë të nevojshme analiza të mëtejshme janë rezultatet që në të tre rastet, qytetarët raportojnë se janë më pak të kënaqur edhe pse kanë më shumë besim tek institucionet përkatëse.

Fig. 39

Bashkëlidhja mes besimit dhe kënaqshmërisë



Qytetarët u pyetën nëse janë dijeni për sistemin e ankesave që mund të ketë krijuar bashkia dhe nëse kanë besim tek një sistem i tillë.

41% e shqiptarëve të intervistuar pohuan se bashkia ku ata banojnë ka një mekanizëm të instaluar për mbledhjen e ankesave (mekanizëm elektronik ose ndonjë tjetër), ndërsa 33% e të anketuarve nuk janë në dijeni të ekzistencës së një sistemi të tillë.

Për më tepër, 1 në 4 qytetarë të anketuar (25%) besojnë se bashkia ku ata banojnë dëgjon dhe trajton siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët, në krahasim me 38% që nuk e besojnë një gjë të tillë.

Fig. 40

A ka Bashkia ku ju banoni një sistem për të marrë ankesat e qytetarëve në lidhje me pakënaqësitë e tyre në ofrimin e shërbimeve publike??





Fig. 41

A mendoni se Bashkia i “dëgjon” dhe i adreson në mënyrën e duhur ankesat e qytetarëve?





poshtëshënime

1. Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, dhe Serbi
2. Shqipëria: IDM Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim; Bosnje-Hercegovinë: ANALITIKA Qendra për Kërkimin Social, Kosovë: Instituti Riinvest, Maqedoni: CRPM Qendra për Kërkime dhe Hartim Politikash; Mali i Zi: CEDEM Qendra për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut; CEMI Qendra e Monitorimit; dhe Serbi: CEAS Qendra për Studime Euro-Atlantike
3. Easton D (1965) Një analizë e sistemeve të jetës politike, John Wiley, New York.
4. OECD (2013), Qeveria me një vështrim 2013, publikimet OECD , www.oecd.org
5. Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin besimin institucional në një shkallë nga “Kam shumë besim” në “Nuk kam aspak besim” (1-4).
6. Krahasimi i përgjigjeve “Kam shumë besim” me ato të “Kam pak besim”.
7. Ndërthurja e atyre që shprehen “nuk jam dakord” me ata të “nuk jam aspak dakord”.
8. Ndërthurja e përgjigjeve “plotësisht dakord” me ato “pak a shumë dakord”.
9. Për kategorinë “Dakord”, janë përmbledhur përqindjet e “Plotësisht dakord” me “Disi dakord” dhe “Dakord”. Për kategorinë “Nuk jam dakord”, janë përmbledhur përqindjet e kategorisë “Nuk jam dakord”, dhe “Nuk jam aspak dakord”. Këtu nuk tregohen përgjigjet “Nuk kam opinion”.
10. Shpjegimi si më sipër.
11. Shpjegimi si më sipër.
12. Vlen të theksohet kuptimi i ngushtë dhe niveli i dallimit nga ana e qytetarëve të dy termave të përdorur gjerësisht në ditët e sotme: “bilbilfryrja” dhe “rrjedhja (e informacionit)”. Duke qenë se dallimi mes bilbilfryrjes dhe rrjedhjes së informacionit është mjaft i paqartë këto kohët e fundit, qëllimi i veprimit e bën krejt të qartë dallimin mes këtyre dy proceseve. Bilbilfryrja ka të bëjë me raportimin e aktiviteteve të paligjshme apo shpërdorimit të detyrës tek media apo institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve përkatëse. Informatorët (bilbilfryrësit) presupozohet se duhet të jenë të mbrojtur nga hakmarrja e punëdhënësit (p.sh., pushimi nga puna). Nga ana tjetër, ligji nuk e mbron informacionin që rrjedh, pasi këtu përfshihet nxjerrja e paligjshme e sekreteve dhe informacionit konfidencial të kompanive ose qeverisë tek persona apo palë të tjera. Shqipëria ka përgatitur një projektligj për bilbilfryrësit (të paraqitur në Kuvend më 23 dhjetor 2015). Pas miratimit të ligjit, është e nevojshme të ndërmerren fushata të gjera informimi të publikut të gjerë.
13. <http://www.opengovpartnership.org/>
14. OECD, 2009, Fokusi tek Qytetarët: Angazhimi qytetar për Politika dhe Shërbime më të mira, www.oecd.org
15. Brodie, E; Hughes, T; Jochum, V; Miller, S; Ockenden, N; & Warburton, D, 2011, Rrugët drejt pjesëmarrjes: Ç'farë krijon dhe nxit qytetarë aktivë?
16. Banka Botërore, 2012, Interesat private të zyrtarit publik: Përgjegjshmëria nëpërmjet deklarimit të të ardhurave dhe pasurisë, Uashington DC
17. Po aty, f. 6
18. Për qëllime krahasimi me vitin 2014, janë përmbledhur kategoria “i përgjegjshëm”, përqindjet e “shumë” dhe “mjaftueshëm”.
19. Partneriteti i Qeverisjes së Hapur, <http://www.opengovpartnership.org/>
20. Nga 61 Bashki, 15 prej tyre kanë adresë aktive në internet.
21. Për kategorinë “E përdor”, janë përmbledhur përqindjet e “Shumë shpesh” me “Shpesh” dhe “Ndonjëherë”.

22. OECD (2013), Qeveria me një shikim 2013, Botimet OECD, www.oecd.org
23. Për qëllime krahasimi me vitin 2014, për kategorinë “ndikimi”, janë përmbledhur përqindjet e “ndikim shumë të madh” dhe “ndikim të mjaftueshëm”.
24. Jarl K Kampen, J. K., Van de Walle, S., & Bouckaert, G. (2006). ‘Vlerësimi i lidhjes mes kënaqësisë me ofrimin e shërbimeve publike dhe besimit në qeveri: Ndikimi i vullnetit të qytetarëve ndaj qeverisë për vlerësimin e punës së saj “. Në: Rishikimin e Menaxhimit dhe Performancën Publike, 29 (4): 387-404.
25. Van de Walle , Steven dhe Bouckaert, Geert , Performanca e Shërbimit Publik dhe Besimi në Qeveri: Problemi i shkakësisë (13 shtator 2003) . Van de Walle , S. & Geert Bouckaert , Performanca e Shërbimit Publik dhe Besimi në Qeveri : Problemi i shkakësisë , në : International Journal of Administratës Publike , Vol . 29 (8 dhe 9): 891-913 . Në dispozicion në SSRN : <http://ssrn.com/abstract=2325327>
26. Bashkimi i përgjigjeve “shumë i pakënaqur” me “i pakënaqur”.
27. Njësoj si më sipër.
28. Njësoj si më sipër.
29. Për qëllime krahasimi me 2014, kategoria “i kënaqur”, janë përmbledhur përqindjet e “shumë i kënaqur” me “i kënaqur”.

PYETËSOR

SEKSIONI I

SHËNO QYTETIN / FSHATIN

P1: Gjinia:

1. Mashkull
2. Femër

P2: Mosha:

1. 18 – 25 vjeç
2. 26 – 35 vjeç
3. 36 – 45 vjeç
4. 46 – 55 vjeç
5. 56 – 65 vjeç
6. Mbi 66 vjeç
99. REFUZIM

P3: Nivel i arsimit?

1. I/E pa-arsimuar
2. Mbaruar shkollën fillore – 4 vjeçare
3. Mbaruar shkollën 8/9 - vjeçare
4. Mbaruar shkollën e mesme
5. Diplomë universitare / më lart
99. REFUZIM

P4: Cili është statusi i juaj i punësimit?

1. I/E punësuar
2. I/E pa punësuar – kërkon punë
3. I/E pa punësuar – nuk kërkon punë
4. Student
5. Pensionist
6. Tjetër _____
99. REFUZIM

P5: Të ardhurat e rregullta individuale mujore?

1. Nuk kam të ardhura
2. Deri në 20.000 lekë / muaj
3. Nga 20 001-50 000 lekë / muaj
4. Nga 50 001-70 000 lekë / muaj
5. Mbi 70 001 lekë / muaj
99. REFUZIM

SEKSIONI II

P1: BESIMI

Sa besim keni tek institucionet e mëposhtme?

Nr	Institucione	Kam shumë besim	Kam besim	Nuk kam besim	Nuk kam fare besim	Nuk kam mendim / REFUZIM
1	Qeveria (Këshilli i Ministrave)	1	2	3	4	99
2	Presidenti	1	2	3	4	99
3	Parlamenti	1	2	3	4	99
4	Sistemi gjyqësor	1	2	3	4	99
5	Policia e shtetit	1	2	3	4	99
6	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	2	3	4	99
7	Institucionet fetare	1	2	3	4	99
8	Forcat e Armatosura (Ushtria)	1	2	3	4	99
9	Partitë politike	1	2	3	4	99
10	Institucionet e sistemit shëndetësor	1	2	3	4	99
11	Institucionet e sistemit arsimor	1	2	3	4	99
12	Bashkimi Evropian	1	2	3	4	99
13	NATO	1	2	3	4	99
14	Organizata jo-fitim prurëse / Shoqëria Civile (OJF)	1	2	3	4	99
15	Media	1	2	3	4	99

P2: TRANSPARENCA

Nr	To what extent do you agree with the following statements?	1= Jam plotësisht dakord	2= Në përgjithësi jam dakord	3= Në përgjithësi nuk jam dakord	4= Nuk jam aspak dakord	99=Nuk kam mendim / REFUZIM
1	Transparenca e lartë e aktiviteteve të qeverisë e bën shtetin tonë më të cënueshëm dhe më të dobët	1	2	3	4	99
2	Politikanët, deputetët dhe të zgjedhurit vendorë kanë të drejtë të mbajnë sekret dhe konfidencial informacionin mbi të ardhurat personale dhe pasurinë e tyre	1	2	3	4	99
3	Informacioni mbi kontratat e punëve publike dhe investimeve të financuara nga qeveria duhet të bëhet publik për qytetarët	1	2	3	4	99
4	Për të pasur një politikë sa më të drejtë punësimi në sektorin publik, duhet të kërkohet informacion për prejardhjen etnike dhe/ose bindjet fetare	1	2	3	4	99
5	Nëpunësi i cili nxjerr sekrete dhe informacione KONFIDENCIALE mbi aktivitetet e institucionit shtetëror ku punon duhet të dënohet	1	2	3	4	99
6	Institucionet shtetërore publikojnë me transparencë dhe llogaridhënie informacion mbi punën e kryer prej tyre	1	2	3	4	99

P3: A keni qenë dëshmitar i ndonjë rasti korrupsioni të ndodhura në institucionet publike gjatë vitit të fundit?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di / REFUZIM

P4: Sipas mendimit tuaj, cilat janë format më shpeshta të korrupsionit në Institucionet Publike? (mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

1. Nepotizmi në punësimin e zyrtarëve
2. Parregullsi në dhënien e tenderave / lejeve / koncesioneve?
3. Abuzimi/vjedhja e fondeve publike
4. Keq-administrimi i fondeve publike
5. Përdorimi i postit për kërcënim dhe shantazh

6. Patronazhi dhe favoritizimi
7. Shkëmbimi i interesave midis zyrtarëve
8. Tjetër: Ju lutem specifikoni
 - a. _____

P5: PJESEMARRJA E QYTETARËVE

Nr	Sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme? Deklarata					
		1= Jam plotësisht dakord 2= Në përgjithësi jam dakord 3= Në përgjithësi nuk jam dakord 4= Nuk jam aspak dakord 99= Nuk kam mendim / REFUZIM				
1	Qytetari nuk ka njohurinë e duhur për të gjykuar nëse vendimet e qeverisë janë të drejta apo të gabuara	1	2	3	4	99
2	Deputetët janë përgjegjës për të përfaqësuar mendimin e qytetarëve në lidhje me politikat publike	1	2	3	4	99
3	Lobimi pranë vendimmarrësve dhe politikanëve është i keq për shoqërinë	1	2	3	4	99
4	Dëgjesat me publikun që bëhen në këshillat e bashkive janë vetëm formale dhe nuk ndikojnë në vendimet që marrin bashkitë	1	2	3	4	99
5	Diskutimet / komentet në internet nuk e përfaqësojnë mendimin publik në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme.	1	2	3	4	99

P6: A keni marrë pjesë në ndonjë protestë/ tubim apo keni nënshkruar ndonjëherë ndonjë peticion?

1. Po
2. Jo
3. REFUZIM

P7: LLOGARIDHËNIA

Nr	Sa ndikim kanë institucionet e mëposhtme për ta bërë Qeverinë sa më të përgjegjshme (të japë llogari) ndaj qytetarëve?					
		1	2	3	4	99
		1 = Ndikon shumë				
		2= Ndikon				
		3= Nuk ndikon				
		4= Nuk ndikon aspak				
		99= Nuk kam mendim / REFUZIM				
1	Parlamenti	1	2	3	4	99
2	Deputetët	1	2	3	4	99
3	Partitë politike (opozitare)	1	2	3	4	99
4	Kontrolli i Lartë i Shtetit	1	2	3	4	99
5	Avokati i popullit	1	2	3	4	99
6	Media	1	2	3	4	99
7	Sindikatat	1	2	3	4	99
8	Organizatat jo-fitimprurëse / shoqëria civile	1	2	3	4	99
9	Institucionet fetare	1	2	3	4	99
10	Organizatat ndërkombëtare (EU , NATO etj)	1	2	3	4	99
11	Biznesi	1	2	3	4	99

P8: PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË

A mendoni se përdorimi i teknologjisë së informacionit mund të përmirësojë qeverisjen?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di /REFUZIM

P.9.a. A ka Bashkia ku ju banoni një faqe interneti?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

Vazhdoni te Seksioni III

Vazhdoni te Seksioni III

Nr	P9/b: Si dhe sa e shfrytëzoni faqen e internetit të Bashkisë ku ju banoni?	1= Shumë shpesh	2=Shpesh	3=Ndonjëherë	4= Asnjëherë	99= Nuk kam mendim / REFUZIM
1	Kontrolloj programet që publikohen për qytetin/fshatin tim	1	2	3	4	99
2	Lexoj vendimet e Këshillit të Bashkisë procesverbalet e mbledhjeve	1	2	3	4	99
3	Komunikoj me përfaqësuesin e këshillit të Bashkisë nëpërmjet internetit (e-mail)	1	2	3	4	99
4	Dërgoj ankesa apo komente te zyra përgjegjëse të Bashkisë nëpërmjet internetit (e-mail)	1	2	3	4	99
5	Dorëzoj dokumente të ndryshme nëpërmjet internetit (e-mail)	1	2	3	4	99

SEKSIONI III

P1. Si e vlerësoni kryerjen e funksioneve kryesore të këtyre institucioneve?

Nr	Institucionet	Të shkëlqyer	Shumë të mirë	Neutral	Të dobët	Shumë të dobët	Nuk kam mendim / REFUZIM
1	Qeveria qendrore	1	2	3	4	5	99
2	Qeveria vendore	1	2	3	4	5	99
3	Presidenti	1	2	3	4	5	99
4	Parlamenti	1	2	3	4	5	99
5	Sistemi gjyqësor	1	2	3	4	5	99
6	Policia	1	2	3	4	5	99
7	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	2	3	4	5	99
8	Institucionet fetare	1	2	3	4	5	99
9	Ushtria	1	2	3	4	5	99
10	Partitë Politike	1	2	3	4	5	99

P 2. Sa ndikon politika (interesat politike) në punën e institucioneve të mëposhtme?

Nr	Institucionet	Nuk ndikon fare	Nuk ndikon	Neutral	Ndikon deri diku	Ndikon shumë	Nuk kam mendim / REFUZIM
1	Judiciary	1	2	3	4	5	99
2	Police	1	2	3	4	5	99
3	Central Election Committee	1	2	3	4	5	99
4	Religious Institutions	1	2	3	4	5	99
5	Army	1	2	3	4	5	99
6	Health system institutions	1	2	3	4	5	99
7	Education system institutions	1	2	3	4	5	99
8	Institutions delivering social services	1	2	3	4	5	99

P3. Sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme?

Nr	Deklarata	Jam plotësisht dakord	Jam deri diku dakord	Neutral	Nuk jam dakord	Nuk jam aspak dakord	Nuk kam mendim / REFUZIM
1	Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike	1	2	3	4	5	99
2	Në Shqipëri, nëpunësit civilë iu shërbejnë me të njëjtën gatishmëri dhe etikë si burrave dhe grave	1	2	3	4	5	99

Nr	Deklarata	Jam plotësisht dakord	Jam deri diku dakord	Neutral	Nuk jam dakord	Nuk jam aspak dakord	Nuk kam mendim / REFUZIM
3	Institucionet publike marrin parasysh ndryshimet/ nevojat e ndryshme gjinore gjatë hartimit të programeve dhe politikave	1	2	3	4	5	99
4	Parlamenti është i hapur për t'u konsultuar me shoqërinë civile dhe grupet e interesit gjatë seancave dëgjimore të komisioneve parlamentare	1	2	3	4	5	99
5	Sugjerimet e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit mbi draft ligjet merren në konsideratë nga parlamenti	1	2	3	4	5	99

P4. A mendoni se institucionet publike në Shqipëri mund të kryejnë funksionet e tyre më mirë?

1. Po (vazhdo tek pyetja 7)
2. Jo (vazhdo tek pyetja 6)
3. Nuk e di / REFUZIM

P5. Nëse iu përgjigjët JO pyetjes nr 4, ju lutem rendisni arsyet e mëposhtme sipas rëndësisë së tyre.

Nr	Arsyeja	Shumë e rëndësishme	E rëndësishme	Neutral	Jo e rëndësishme	Aspak e rëndësishme	Nuk kam mendim / REFUZIM
1	Nuk ka vullnet	1	2	3	4	5	99
2	Mungesë kapacitetesh infrastrukture	1	2	3	4	5	99
3	Stafi nuk është i kualifikuar	1	2	3	4	5	99
4	Ndërhyrjet politike / ndryshimet e shpeshta të stafit	1	2	3	4	5	99
5	Politika punësimi jo – transparente dhe jo të rregullta	1	2	3	4	5	99
6	Mungesë vizioni dhe vazhdimësie	1	2	3	4	5	99

P6. Sa I/E kënaqur jeni me cilësinë dhe profesionalizmin e ofrimit të shërbimeve publike?

Nr	Institucioni	Shumë i pakënaqur	I pakënaqur	Neutral	I kënaqur	Shumë i kënaqur	Nuk kam mendim / REFUZIM
1	Në sistemin shëndetësor	1	2	3	4	5	99
2	Në sistemin arsimor (duke përfshirë sistemin parashkollor)	1	2	3	4	5	99
3	Universitetet publike	1	2	3	4	5	99
4	Transporti publik	1	2	3	4	5	99
5	Shërbimet sociale	1	2	3	4	5	99
6	Shërbimet e punësimit	1	2	3	4	5	99

Nr	Institucioni	Shumë i pakë- naqur	I pakë- naqur	Neutral	I këna- qur	Shumë i këna- qur	Nuk kam mendim / REFUZIM
7	Shërbimet emergjente (policia, zjarrfikësja, ndihma e parë)	1	2	3	4	5	99
8	Shërbimet komunale (pastrimi, gjelbërimi)	1	2	3	4	5	99
9	Dhënia e lejeve dhe rregjistrimi i bizneseve	1	2	3	4	5	99
10	Rregjistrimi i pronave	1	2	3	4	5	99
11	Shërbimet gjyqësore	1	2	3	4	5	99
12	Shërbimet e drejtorive rajonale të mjedisit	1	2	3	4	5	99

P7: A jeni në dijeni nëse Bashkia ku ju banoni ka një sistem për të marrë ankesat e qytetarëve në lidhje me pakënaqësitë e tyre në ofrimin e shërbimeve publike?

1. Po Kalo tek pyetja 9/a
2. Jo
3. Nuk e di /REFUZIM

P 7/a : A mendoni se Bashkia i “dëgjon” dhe i adreson në mënyrën e duhur ankesat e qytetarëve?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di / REFUZIM

P 8: A keni dëgjuar për raste korrupsioni të ndodhura në Bashkinë ku ju banoni gjatë vitit të fundit?

4. Po
5. Jo
6. Nuk e di / REFUZIM

P 9: Sipas mendimit tuaj, cilat janë format më shpeshta të korrupsionit në Bashkinë tuaj? (mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

1. Nepotizmi në punësimin e zyrtarëve
2. Parregullsi në dhënien e tenderave / lejeve / koncesioneve?
3. Abuzimi/vjedhja e fondeve publike
4. Keq-administrimi i fondeve publike
5. Përdorimi i postit për kërcënim dhe shantazh
6. Patronazhi dhe favoritizmi
7. Shkëmbimi i interesave midis zyrtarëve
8. Tjetër: Ju lutem specifikoni
 - a. _____

SEKSIONI IV

P1 : A keni dorëzuar ndonjëherë një kërkesë zyrtare për të marrë informacion apo të dhëna nga institucionet shtetërore?

1. Po
2. Jo

P2: Sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme?

Nr	Deklarata	Jam plotësisht dakord	Jam deri diku dakord	Neutral	Nuk jam dakord	Nuk jam aspak dakord	Nuk kam mendim /Refuzim
1	Të dhënat e hapura e forcojnë marrëdhënien e qeverisë me qytetarët dhe grupet e interesit	1	2	3	4	5	99
2	Të dhënat e hapura e rrisin besimin e qytetarëve tek qeveria	1	2	3	4	5	99
3	Të dhënat e hapura nxisin zhvillimin e ekonomisë	1	2	3	4	5	99
4	Të dhënat e hapura e përmirësojnë jetën e qytetarëve	1	2	3	4	5	99

JU FALËMINDERIT!

